



Datë: 22.05.2026

A.nr.2028/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2028/2025, të datës 15.12.2025, të parashtruar nga ankuesi B.S., më objekt *“kundërshtim i masës disiplinore”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.2028/2025, e datës 15.12.2025, e parashtruar nga ankuesi B.S.

II. Mbetet në fuqi masa disiplinore “vërejtje me shkrim” e shqiptuar ndaj ankuesit përmes parashtresës me numër protokoll 03 Nr.03/9533, të datës 17.11.2025, të Drejtores së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Hanit të Elezit.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, B.S. (*tutje referuar ankuesi*), më datë 15.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore “vërejtje me shkrim” e shqiptuar përmes shkresës më numër protokoll Nr.03/9533, të datës 17.11.2025, të Drejtores së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Hanit të Elezit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Hanit të Elezit, ndërsa, kjo e fundit, ka percjell shkresat ndërlidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 7896/2025, me numër protokoll 15.12.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Masa disiplinore-Vërejtja me shkrim me numër protokoll Nr.9533, të datës 17.11.2025; Dëshminë për mungese në punë të datës 10.11.2025, Njoftimin e datës 11.10.2025; Raportet mjeksore të datës 10.11.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të

ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë 19.12.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 05.01.2025; Akt emërimit me numër Nr.5649/2025, të datës 03.08.2025; Përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin Nr.02.559/2011; Përgjigjen lidhur me vrejtjen me shkrim Nr.10492, të datës 29.12.2011; Njoftimin e datës 15.12.2025; Procesverbalin Nr.9499, të datës 14.11.2025; Vendimin Nr.9106/2025, të datës 10.12.2025; Komunikimet elektronike; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë me numër protokolli Nr.03/1269, e datës 24.02.2025; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimit publik për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional; Raportin e prezencës në punë dt: 07.11.2025 deri 10.11.2025; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimit publik për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional 2024; Vrejtjen me shkrim të datës 13.02.2023;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rrejdhe se ankuesi është i punësuar në Komunën e Hanit të Elezit, dhe se i njëjti sipas Akt Emërimit me numër protokolli 5649/2024, të datës 03.07.2024, ushtron pozitën e punës Zyrtar i Arkivit dhe Transparencës, në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme.

Tutje sipas shkresave të lëndës del se Drejtoresha e Administratës së Përgjithshme në Komunën e Hanit të Elezit, në cilësinë e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë përmes shkresës me numër protokolli Nr.03/9533, të datës 17.11.2025, ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore “vërejtje me shkrim”, me arsyetimin se “*më datë 10.11.2025, nuk ka qenë prezent në vendin e punës dhe nuk ka kryer njoftimin e detyrueshëm ndaj mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë, siç e përcakton edhe Rregullorja (QRK) Nr.04/2024*”.

Ankuesi më datë 15.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar masën disiplinore “vërejtje me shkrim” të datës 17.11.2025, mbi pretendimin ankimor se ka qenë në pushim mjekësor dhe se sipas emailit të datës 10.11.2025, kam njoftuar drejtoreshën se do të jem në pushim mjekësor nga data 10.11.2025 deri më 14.11.2025, duke i përcjell po në atë ditë edhe dëshmitë mjekësore, andaj, sipas ankuesit i njëjti ka plotësuar të gjitha kërkesat sipas Rregullores Nr.04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publikë.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve të ankueses, Kolegji i Këshillit iu refrua Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë:

-Nenit 55 paragrafi 1: “*Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim*”.

-Nenit 56, paragrafi 1: “*Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun.*

-Nenit 57: 1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; 1.3. vërejtje me shkrim...

-Nenit 58, paragrafi 1 dhe 2: 1. Masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe/apo nga udhëheqësja/i më i lartë administrativ. 2. Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor.

-Nenit 61 paragrafi 1: 1. Për përcaktimin e masës disiplinore mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 62 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunëses/it për shmangien apo kufizimin e dëmit.

Ndërsa, ndërlidhur më detyrimin e zyrtarit publik për respektim të orarit të punës dhe njoftimin për mungesë në punë, Kolegji i Këshillit i'u referua Rregullores në fuqi (QRK) Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik, respektivisht, nenit 4, 11 dhe 12 ku përcaktohet: **Neni 4.** 1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës zyrtari publik kryen punë ose shërbime në të mirë të institucionit. 4.2. Orari i punës së zyrtarëve publik fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00, pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten, përveç nëse caktohet ndryshe nga institucioni përkatës për shkak të natyrës së punës. ...” **Neni 11** Pushimi mjekësor 1. Zyrtari publik në rast të sëmundjes ka të drejtë për pushim mjekësor në kohëzgjatje deri njëzet (20) ditë punë brenda një (1) viti me kompensim 100% të pagës. 2. Zyrtari publik i cili e shfrytëzon pushimin mjekësor, duhet të informoj mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë dhe të ofrojë dëshminë përkatëse nga organi kompetent mjekësor. 3. Ditët e parapara për pushim mjekësor zyrtari publik mund ti shfrytëzojë edhe në rast të sëmundjes së fëmijës së tij, me dëshmi të organit mjekësor. 4. Zyrtari publik ka të drejtë për kompensim të pushimit mjekësor si pasojë e lëndimit në punë, ose sëmundjes profesionale të ndërlidhur me kryerjen e punëve dhe të shërbimeve për institucionin, në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune me kompensim prej 70 % të pagës së tij. 5. Dëshmi nga organi kompetent mjekësor, sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, nënkupton dëshminë e cila përcakton qartë ditët e mungesës në punë për shkak të gjendjes së tij mjekësore. 6. Pas kalimit të periudhës me kompensim, sipas paragrafit 1 dhe 3 të këtij neni, zyrtari publik me rekomandimin e organit kompetent mjekësor ka të drejtë të vazhdojë pushimin mjekësor pa pagesë. 7. Për kohën e mungesës në punë pa pagesë nga paragrafi 6 i këtij neni, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës për kthim në vendin tij të punës. **Neni 12.** 1. Iajmërimi për paaftësinë e përkohshme për punë 1. Në rast të sëmundjes ose paaftësisë së përkohshme për punë, zyrtari publik është i obliguar të informojë mbikëqyrësin e drejtpërdrejt menjëherë ose më së largu gjatë ditës së mungesës nga puna....

Bazuar në kuadrin si më lartë si dhe nga analizimi i shkresave të lëndës Kolegji erdhi në përfundimin së akti i kontestuar më ankesë bazohet në vërtetim të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të drejtë të së drejtës materiale, sepse, është fakt i pa kontestueshëm së ankuesi ka prezantuar dëshmi mjekësore për mungesën në punë lidhur më periudhën 10 deri 14 nëntor 2025, mirëpo, i njëjti më datë 10 nëntor 2025, edhe pse nuk ishte në punë, nuk kishte njoftuar me kohë mungesën në punë tek organi kompetent në këtë rast të mbikëqyrësi, rrjedhimisht, vetëm pas emalit të orës 11 : 44 të mbikëqyrëses se tij, më te cilin ankuesi njoftohet së nuk ka qenë në punë, ky i fundit po përmes emalit të datës 10 nëntor 2025 ora 12:36, informon mbikëqyrësen se nga data 10 deri 14 nëntor do te jetë në pushim mjekësor dhe së ankuesi më

as një dëshmi nuk ka rritur të argumentoj shkakun e pamundësisë për njoftim me kohë lidhur me mungesën e tij në punë.

Në fakt, në vlerësimin e Kolegjit njoftimi më kohë i mungesës në punë qoftë për arsye shëndetësore apo arsye tjetra ligjore konsiston në menaxhim dhe funksionim të rregullt të aktiviteteve të institucionit, sepse në rastin e ankuesit i njëjti më datë 10.11.2025 është dashur të jetë prezent në mbledhjen e planifikuar të Bordit të Drejtoreve të Komunës së Hanit të Elezit, andaj, edhe njoftimi më kohë i mungesës së ankuesit do të ofronte mundësi të zëvendësimit të tij dhe përmbushje të detyrave zyrtare.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit në veprimet e ankuesit manifestohen elementet e shkeljes së lehtë disiplinore, andaj, mbikëqyrësja e ankuesit më të drejtë ka cilësuar veprimet e ankuesit si shkelje e lehtë disiplinore, masa e shqiptuar është në proporcion me shkeljen e ndodhur dhe se janë marr për bazë parimet e individualizmit të masës, pasi që edhe nga provat e çështjes rezulton se ankuesit në mënyrë të vazhdueshëm i është tërhequr vërejtja për mos respektim të orarit dhe mungesën në punë, fakte këto të provuar nga e-mailat e Drejtoreshës së Administratës së Përgjithshme të datës 28.10.2025, 30.10.2025 dhe 14.10.2025.

Bazuar në rrethanat dhe konstatimet si më sipër, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.2028/2025

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

-Ankuesit, B.S.;

-Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Hanit të Elezit; dhe

-Arkivit të KPMSHCK-së.